

Mikrofinanca në Evropë: Raporti i Studimit

Botim i vitit 2022

Justyna Pytkowska

Përmbledhje ekzekutive

Botimi i vitit 2022 i Studimit Mikrofinanca në Evropë paraqet një panoramë të sektorit të mikrofinancës gjatë periudhës 2020-2021, gjatë dhe pas fazës më të vështirë të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Ky është botimi i 10-të i këtij studimi të përgjithshëm për Rrjetin Evropian të Mikrofinancave (EMN) dhe për herë të katërt realizohet në

bashkëpunim me Qendrën për Mikrofinancën (MFC). Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy rrjeteve bën të mundur që studimi të mbulojë pjesën më të madhe të sektorit të mikrofinancës në Evropë, duke ofruar grupin më të plotë të të dhënave të disponueshme aktualisht.

Studimi përfshin 156 institucione nga 30 shtete dhe mbledh të dhëna për periudhën kohore 2020-2021.

Gjetjet kryesore

Për sa u përket **karakteristikave institucionale**, pjesa më e madhe e ofruesve të shërbimeve mikrofinanciare janë institucione mikrofinanciare (IMF) jobanka (94%), të cilat operojnë në treg si organizata jofitimprurëse (OJF), institucione financiare jobankë (IFJB), organizma qeveritare dhe kooperativa. Në Evropën Lindore, shërbimet mikrofinanciare ofrohen kryesisht nëpërmjet kooperativave dhe IFJB-ve, ndërsa në Evropën Perëndimore në sektorin e mikrofinancës mbizotërojnë bankat dhe OJF-të. IMF-të në Evropën Perëndimore kryesisht të krijuara kohët e fundit, janë më të pakta në numër dhe kanë më pak persona të punësuar. Megjithatë, ato angazhojnë një numër të madh vullnetarësh të cilët mbështesin dhënien e shërbimeve financiare dhe jofinanciare për grupet vulnerabël.

Femrat përbëjnë 63% të stafit të punësuar me pagesë në IMF-të evropiane, ku përqindja e femrave të punësuar në IMF-të në Evropën Lindore është relativisht më e lartë (68%) në krahasim me ato në Evropën Perëndimore (53%).

76% e IMF-ve ofrojnë **shërbime jofinanciare**, veçanërisht në Evropën Perëndimore. Në Evropën Perëndimore, shërbimet për zhvillimin e klientit janë ato më pak të përhapurat, pasi pjesa më e madhe e IMF-ve angazhohen në shërbime për zhvillimin e biznesit apo për zhvillimin e sipërmarrjes. Në Evropën Lindore, IMF-të angazhohen në nivele të ngjashme në secilin prej shërbimeve jofinanciare me prirje më të madhe drejt shërbimeve për zhvillimin e klientit se sa për llojet e tjera, pasi ata ofrojnë më shpesh kredi për qëllime personale dhe për strehim dhe i mbështesin klientët e tyre për administrimin e buxhetit familjar nëpërmjet shërbimeve për zhvillimin e klientit.

Ndonëse mbështetja e personalizuar e ofruar personalisht është mënyra më e zakonshme e ofrimit të shërbimeve jofinanciare, 50%

e IMF-ve janë përdorin aktualisht kanale dixhitale për të ofruar shërbime jofinanciare.

Pas vitit pandemik 2020, ecuria në sektorin e mikrofinancës u rikthye në **nivelin** që kishte shënuar para pandemisë, duke arritur gjithsej 1,4 milionë kredimarrës aktivë dhe portofol të kredive bruto në vlerën prej 4,3 miliardë euro, në vitin 2021.

Për sa u përket **objektivave sociale**, përfshirja financiare mbetet prioriteti kryesor i IMF-ve, duke pasqyruar në këtë mënyrë një vizion të qëndrueshëm për këtë sektor. Gratë dhe popullsia në zonat rurale janë dy grupet kryesore të synuara. Një e katërta e IMF-ve u japin prioritet pakicave etnike/emigrantëve/refugjatëve dhe disa IMF planifikojnë të nisin apo të zgjerojnë angazhimin e tyre me emigrantët/refugjatët në dy vitet e ardhshme. Ato IMF që janë tashmë të angazhuara me emigrantët/refugjatët janë kryesisht OJF që ushtrojnë aktivitetin në Evropën Perëndimore. IFJB-të dhe kooperativat si në Evropën Lindore edhe në Evropën Perëndimore janë institucionet kryesore që po marrin në konsideratë rritjen e ekspozimit të tyre ndaj emigrantëve/refugjatëve në të ardhmen. Garancitë rezultojnë të jenë forma më e pëlqyer e mbështetjes për IMF-të që dëshirojnë ta rrisin angazhimin për mbështetjen ndaj emigrantëve, pasuar nga grantet për mbështetjen e ofrimit të shërbimeve jofinanciare. Ndërkohë, 28% e IMF-ve nuk kanë nevojë për fonde shtesë për t'u shërbyer emigrantëve/refugjatëve.

Mesatarisht, IMF-të pjesë e studimit, i shërbejnë një tregu relativisht të gjerë. Niveli mesatar i shtrirjes, i shprehur si raport i balancës mesatare të kredisë ndaj të ardhurave kombëtare bruto për frymë, ishte 56% në vitin 2021.

Ndërkohë që shumë IMF e masin ndikimin e mikrokredive me zhvillimin e klientëve të tyre, një numër i konsiderueshëm i IMF-ve (38%) nuk e masin ndryshimin në nivel klienti. Më së shumti,

IMF-të e masin ndikimin duke marrë për bazë numrin e vendeve të punës të krijuara si rrjedhojë e investimeve në biznes (44%), numrin e bizneseve të krijuara (32%), apo numrin e vendeve të punës të ruajtura (30%).

Në varësi të llojit të kredisë ose të llojit të klientit, IMF-të mund t'u kërkojnë klientëve garanci të ndryshme për të siguruar kreditë. Pjesa më e madhe e IMF-ve kërkojnë që kreditë të garantohen nga një person tjetër, i cili bëhet dorëzues individual (67% e IMF-ve) ose bashkëpunues (41% e IMF-ve). Aktivitetet e vendosura si kolateral janë një formë tjetër e zakonshme që u kërkohet disa klientëve nga 34% e IMF-ve. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm i IMF-ve (35%) japin kredi të pakolateralizuara për disa prej klientëve të tyre.

Në vitin 2021, vlera mesatare e portofolit në rrezik (PAR30) ishte 9,9%.¹ Sipas llojit të institucionit, bankat raportuan portofolet më të shëndetshme ndërsa kooperativat kishin **cilësinë më të dobët të portofoleve**. Janë vënë re edhe disa dallime midis rajoneve; numri i IMF-ve që raportuan portofole të shëndetshme ishte më i lartë në Evropën Lindore (PAR30 nën 5%) se sa në Evropën Perëndimore ku një e treta e IMF-ve raportuan se PAR30 ishte mbi 10%.

Ndërkohë, 71% e IMF-ve pjesë e studimit kishin fonde të mjaftueshme **për të mbështetur veten**: pra, gjeneronin mjaftueshëm të ardhura për të mbuluar shpenzimet e tyre. Ashtu si edhe me tregues të tjerë të fitimit, vlerat e vetëmjaftueshmërisë operative (OSS) ndryshonin në varësi të llojit të institucionit. OJF-të në më të shumtën e rasteve nuk ishin të vetëmjaftueshme nga pikëpamja operative. Numri i IMF-ve në Evropën Lindore, që ishin të vetëmjaftueshme nga pikëpamja operative, ishte më i lartë se numri i atyre në Evropën Perëndimore.

Fondet e huazuara në terma afatgjatë janë **burimi kryesor i financimit**, duke arritur vlerën 1,1 miliardë euro në vitin 2021. Vëllimi më i madh i huamarrjeve (60%) administrohet nga IFJB-të. Depozitat afatgjata të klientëve (0,4 miliardë euro), të cilat tërhiqen nga kooperativat, janë burimi i dytë kryesor i financimit. Në total, IMF-të pjesë e studimit kanë nevojë për 1,3 miliardë euro për të përbushur objektivat e tyre në dy vitet e ardhshme. Gjysma e IMF-

ve kanë nevojë për më pak se 4 milionë euro ndërsa IMF-të më të mëdha kërkojnë deri në 300-400 milionë euro fonde.

Dixhitalizimi dhe mikrofinanca e qëndrueshme ekologjike vijnë të jenë dy tendencat madhore në tregun evropian të mikrofinancës.

84% e IMF-ve kanë zgjidhje dixhitale që i mbështesin klientët për të aplikuar, për të administruar apo për të shlyer një kredi. Më shumë se gjysma e IMF-ve kanë aktualisht një aplikacion në internet për kreditë. Mundësia për të ngarkuar dokumente mbështetëse për aplikimin për kredi është zgjidhja e dytë më e zakonshme, e cila ofrohet nga 51% e IMF-ve. Ndërkohë, 16% e IMF-ve nuk kanë aktualisht ndonjë zgjidhje dixhitale për klientët. Më shumë se gjysma (58%) e institucioneve i ndihmojnë klientët që të mësojnë si të përdorin zgjidhjet dixhitale për të pasur qasje në produktet financiare. Kjo mbështetje jepet zakonisht pranë degëve, por një e treta e IMF-ve kanë zhvilluar kanale virtuale komunikimi për të ofruar asistencë.

Shumë prej IMF-ve në Evropë janë të angazhuara në tranzicionin e gjelbër dhe janë plotësisht ose pjesërisht në përputhje me financimin e gjelbër të qëndrueshëm si dhe me financimin inteligjent për klimën. Përgjegjësia, objektivat apo proceset në lidhje me mjedisin janë pjesë e strategjisë institucionale për afërsisht 40% të IMF-ve. Ndonëse më pak IMF (33%) i raportojnë treguesit të performancës mjedisore, rreth 55% monitorojnë dhe menaxhojnë ndikimet negative të operacioneve të tyre (gjurma e gjelbër).

Monitorimi i ndikimit të klientëve në mjedis dhe përfshirja e këtyre të dhënave në vlerësimin e kredisë është një praktikë më pak e përhapur (27% e IMF-ve) dhe monitorimi i vulnerabiliteteve mjedisore të klientëve zbatohet nga vetëm 15% të institucioneve. 71% e IMF-ve financojnë zgjidhjet ekologjike të klientëve të tyre: Më tej, 26% e realizojnë nëpërmjet produkteve të dedikuara të kredive, ndërsa 45% e IMF-ve financojnë zgjidhjet ekologjike nëpërmjet kredive të zakonshme për mikrondërmarrje apo strehim. Ndërkohë, 23% e IMF-ve planifikojnë të fusin një produkt specifik ekologjik në të ardhmen e afërt dhe 17% e IMF-ve nuk kanë plan të kenë kredi të gjelbra si pjesë e ofertës së tyre.

Rimëkëmbja në periudhën pas COVID-19

Në vitin 2020, pavarësisht nga pandemia dhe izolimi, vlera totale e disbursimeve vjetore u rrit me 6%, duke arritur në vlerën 1,8 miliardë euro. Në vitin 2021, disbursimet u rritën më tej me 11%, duke arritur në vlerën 2 miliardë euro. Rritja për vitin 2020 mund t'i atribuohet kryesisht bankës më të madhe të marrë në analizë si pjesë e studimit. IFJB-të dhe unionet e kreditit patën reduktim të disbursimeve të tyre dhe vetëm OJF-të i rritën ato disi gjatë vitit 2020. Në tërësi, 62% e IMF-ve e reduktuan vlerën e disbursimeve në vitin 2020, vitin e pandemisë. IMF-të në Evropën Lindore e reduktuan vëllimin e kredidhënies me 10% në vitin 2020, ndërsa IMF-të në

Evropën Perëndimore e rritën vlerën totale të disbursimeve me 15%.

Gjatë pandemisë, shumë IMF u përqendruan te rishikimi i afateve të kredive dhe komunikimi me klientët në lidhje me kushtet e reja të shlyerjes. IMF-të që u bënë partnerë zbatues për programet e financimit nga qeveritë dhe disbursuan kredi likuiditeti për mikrondërmarrjet arritën të rrisin në mënyrë të konsiderueshme vëllimet e kredidhënies gjatë pandemisë. Në vitin 2021, viti i rimëkëmbjes, 71% e IMF-ve e rritën vlerën e disbursimeve, kryesisht në Evropën Lindore dhe në të gjitha llojet e institucioneve (përveç OJF-ve).

¹ Vlerat atipike - vlerat jashtë kufijve të vlerës mesatare +/- 3 devijime standarde, janë përjashtuar.

With contribution
by EIF



EMN receives funding from the European Union within the framework of a partnership agreement to support EU-level networks active in the areas of social enterprise finance and microfinance (2022-2025).



EUROPEAN
MICROFINANCE
NETWORK



MICROFINANCE CENTRE